



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.45/6 prot.,

Datë 09.02.2024

V E N D I M
Nr. 167/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-92509-12-29-2023, me objekt “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat” me fond limit 6,932,677.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-01-2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
- Ankimues:** “Kreatx” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, godina 1, Shkalla 1 Zyra nr.2 Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr.133 Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03-01-2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-92509-12-29-2023, me objekt “*Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat*” me fond limit 6,932,677.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-01-2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

II.2. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik “*Kreatx*” SHPK me nr. 45/2024 datë 10.01.2024 si edhe me nr. ankimi elektronik A/2024/3742 datë 09.01.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 18986/7 prot., datë 17.01.2024 protokolluar me tonën me nr. 45/2 prot., datë 19.01.2024 , autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK, dhe ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës.

II.6. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik “Kreatx” SHPK ka paraqitur argumenta shtesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK se:

1.Referuar Kriterit Te Mesiperm Shoqeria “Kreatx” Shpk Konstaton qe kerkesa e mesiperme per piken 4 e cila parashikon qe operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar si prodhues sistemi softëare Nga drejtoria e pergjithshme e tatimeve ose distributor i autorizuar nga prodhuesi, si dhe per Mirembajtjen e zgjidhjes softëar-ike per fiskalizimin, te veprimeve:

? Për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike

Eshte hartuar e pabazuar ne lpp dhe rregullat e prokurimit publik pasi qartesisht eshte nje kerkese diskriminuese per operatoret ekonomike qe duan te marrin pjese ne kete procedure. Arsyetojme qe Kjo kerkese eshte e pa-nevojshme per veprimtarine e UKT dhe e vendosur ne kundërshtim me nenin 3 parime te pergjithshmeë te ligji nr. 162/2020 për Prokurimin Publikë. Me tej ne bindjen tone referuar ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimi të nenit 37, pika 1 i cili thote bankat, institucionet e tjera financiare jobankare dhe Subjekte të tjera, të cilat ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë të faturave elektronike, të lëshuara në transaksione ndërmjet tatimpaguesve ose ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve Publike, për të cilat tatimpaguesi, që lëshon faturë, ka zbatuar procedurën e fiskalizimit, detyrohen të regjistrojnë pagesat e kryera dhe, në mënyrë elektronike, të njoftojnë administratën tatimore qendrore në fund të cdo dite pune për cdo faturë individuale elektronike të paguar gjatë asaj dite.

Kemi bindjen qe citimi ne kriterin e mesiperm nuk i referohet nje operatori ekonomik. Pra pika 4 e ketij kriteri eshte diskriminues dhe kufizon ne menyre te padrejte konkurencen pasi ky lloj Certifikimi eshte specifik dhe mendojme qe nuk eshte kriter i drejte per kete lloj procedure dhe per kete autoritet kontraktor qe ka shpallur proceduren e prokurimit.

Per sa cituam me lart kerkojme modifikimin e ketij kriteri duke e hequr kete kerkese.

III.1.1. Referuar-kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

Fillimisht me poshte, parashtojme me te plote nenin 37 te ligjit Nr. 87/2019 "PËR FATUREN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TE QARKULLIMIT" i cili eshte edhe neni te cilit operatori ekonomik ankimues, i referohet ne menyre te pjesshme. Referuar, Neni 37 te ligjit te sipërcituar, Subjektet qe ofrojne shërbime te pagesave dhe procedurat për regjistrimin e pagesave pa para në dore: Pika 1.

Bankat, institucionet e tjera financiare jobankare dhe subjekte te tjera, te cilat ofrojnë shërbime te pagesave pa para ne dorë te faturave elektronike, të leshuara ne transaksione ndërmjet tatimpaguesve ose ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, për te cilat tatimpaguesi, që lëshon fature, ka zbatuar proceduren e fiskalizimit, detyrohen te regjistrojne pagesat e kryera dhe, ne menyre elektronike, te njoftojne administraten tatimore qendrore në fund te çdo dite pune për çdo fature individuale elektronike te paguar gj atë asaj dite. Pika 2. Subjektet e percaktuara ne pikën 1, te ketij neni, detyrohen te perdorin një pajisje elektronike, te instalojne nje zgjidhje softëare-ike te certifikuar ose nje sistem te integruar kompjuterik te certifikuar apo te perdorin nje aplikacion eeb te certifikuar (Cloud), që mundëson lidhjen e faturave elektronike te leshuara dhe të dhenave te pagesës, si dhe shkëmbimin e mesazheve elektronike me administraten tatimore, nepermjet nje rrjeti te sigurt për transferimin elektronik te te dhenave përmes lidhjes elektronike (internetit). Keto subjekte duhet t° dorezojne pranë administratën tatimore qendrore informacionin për mirembajtësin e zgjidhjes softëare-ike të certifikuar, te përdorur, sipas percaktimeve ne nenin 16 te ketij ligji. ndersa referuar pikes 8, te te njejtit nen, Pika 8. Si perjashtim nga pika 1, e ketij neni, nëse pagesa shte kryer nepërmjet nje ndërmjetësi qe nuk eshte i vendosur ne Republikën e Shqiperise, nese pagesa pa para në dorë është kryer nga bleresi direkt, pa ndërmjetes, nese pagesa është kryer në baze te nje fature te leshuar nga blloku i veçante i faturave, sipas nenit 30, te ketij ligji, ose nese pagesa është kryer sipas nje oferte dhe përpara leshimit të faturës elektronike, ne përputhje me piken 1., te nenit 7, te ketij ligji, atehere vetë tatimpaguesi, qe leshon fature, duhet qe nepërmjet platformes qendrore te faturave te regjistroje te gjitha pagesat e pranuar, jo me vone se ditën e dhjete te muajit pasardhës, për të gjitha pagesat e kryera ne muajin paraardhes. Referuar kerkeses së pikes 1 ju bejme me dije se :

- UKT operon nje rjet te pranimit te pagesave te faturave te leshuara nga UKT ne pika arketimi te shperndara ne territorin e operimit, Tirane.

- Keto pika arketimi, vec operacioneve te tjera ofrojne për konsumantoret individe apo biznese (vecanërisht) shërbimin e pageses te te gjitha faturave të leshuara nga UKT.

- Ne këtë menyre, konsumantoret individe apo biznese vec realizimit te pagesave ne banka apo institucione financiare pagesash, mundet të realizojne pagesen direkt në UKT.

Nga sa me sipër, referuar pikes 1 te nenit 37, ligjit 87/2019 "PËR FATUREN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT", UKT shte ne te gjitha pikat e arkave ofrojne shërbime te pagesave pa para ne dore te faturave elektronike dhe detyrohen te regjistrojne pagesat e kryera dhe në menyre elektronike, te njoftojne administraten tatimore qendrore ne fund te do dite pune për do faturë individuale elektronike te paguar gjatë asaj dite. Referuar pikes 2, UKT detyrohet te instalone nje xgjidhje softëare-ike te certifikuar ose nje sistem te integruar kompjuterik te certifikuar apo te perdorin nje aplikacion eeb te certifikuar (Cloud), që mundëson lidhjen e faturave elektronike te leshuara dhe të dhenave te pagesës. Pra zgjidhjet duhet te jene te certifikuara. Edhe në rastet, kur UKT do te ishte ne kushtet e nje pagese jo raportimi brenda dites (nese pagesa eshte kryer nepermjet nje ndërmjetësi qe nuk eshte i vendosur n Republikën e Shqiperise, nese pagesa pa para ne dore eshte kryer nga blerësi direkt, pa ndërmjetes, nese pagesa eshte kryer në baze te nje fature të leshuar nga blloku i veçante i faturave) realizimi i raportimeve te kërkuara ne piken 8, duke pas parasysh numrin e larte te faturave është i pamundur pa perdorimin e nje zgjidhjeje softëare-ike te certifikuar. Si rrjedhoje, ju bejme me dije se, kerkesat e mësipërme cituar ne piken 2.6 te Krieteve të vencata te Kualifikimit, lidhur me licensimin eshte nje kërkesë e bazuar ne pikën 2 të nenië 37, dhe si e tillë ajo

është e domosdoshme. Per sa më siper ju bejme me dije se pretendimi juai nuk qëndron dhe per rriedhoie nuk pranohet.

III.1.2. Në shtojcën 8 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.6 Operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar si prodhues sistemi softëare nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve ose distributor i autorizuar nga prodhuesi, si dhe per mirembajtjen e zgjidhjes softëar-ike per fiskalizimin, te veprimeve:

- o Me dhe pa para në dorë;*
- o Pa para në dorë E-invoice;*
- o Faturë shoqëruese;*
- o Për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike*
- Certifikimin e kompanise per cloud mbi te cilen operon zgjedhja e ofertuar;*
- Certifikimin e kompanise per sistemeve te raportimit BI; qe ofrohet ne zgjedhjen e ofertuar;*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” i Ligjit Nr.162/2021 “Për prokurimin publik” 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 i Ligjit Nr.162/2021 “Për prokurimin publik” : Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1.4 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.5 . Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve ” pika 2,5 dhe 7 Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “. **Neni 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve**

2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

7. *Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur.*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriteret fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, përkatësisht specifikimeve teknike autoriteti kontraktor, nuk ka cilësuar ansnjë zë për të cilën autoriteti kontraktor përcakton dhe fondin limit referuar kësaj të fundit, që ka të bëjë me kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni vëren se lidhur me argumentimin e autoritetit kontraktor bazuar kjo në ligjin 87/2019 "PËR FATUREN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TE QARKULLIMIT". Referuar, Neni 37 I. Bankat, institucionet e tjera financiare jobankare dhe subjekte të tjera, të cilat ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë të faturave elektronike, të lëshuara në transaksione ndërmjet tatimpaguesve ose ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, për të cilat tatimpaguesi, që lëshon faturë, ka zbatuar procedurën e fiskalizimit, detyrohen të regjistrojnë pagesat e kryera dhe, në mënyrë elektronike, të njoftojnë administratën tatimore qendrorenë fund të çdo dite punepër çdo faturë individuale elektronike të paguar gjatë asaj dite. 2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, detyrohen të përdorin një pajisje elektronike, të instalojnë një zgjidhje softëare-ike të certifikuar ose një sistem të integruar kompjuterik të certifikuar apo të përdorin një aplikacion ëeb të certifikuar (Cloud), që mundëson lidhjen e faturave elektronike të lëshuara dhe të dhënave të pagesës, si dhe shkëmbimin e mesazheve elektronike me administratën tatimore, nëpërmjet një rrjeti të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave përmes lidhjes elektronike (internetit). Këto subjekte duhet të dorëzojnë pranë administratën tatimore qendrore informacionin për mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike të certifikuar, të përdorur, sipas përcaktimeve në nenin 16 të këtij ligji...." Komisioni pasi shqyrtoi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor ku kërkohet "certifikimin si prodhues sistemi software nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose distributor i autorituar nga prodhuesi si dhe për mirëmbajtjen e zgjidhjes softwar-ike për fiskalizimin, te veprimeve: Për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike", vëren se qëllimi i autoritetit kontraktor është mundësimi i fiskalizimit të faturave si dhe menaxhimit të fatures elektronike, ku ky sistem duhet të ofrojë mundësinë e regjistrimit manual të faturave si dhe të mund të integrohet me sistemin e faturimit me UKT si dhe të ketë mundësinë në vazhdim të integrohet me sisteme të tjerë të ngjashëm që UKT mundet të zbatohet në vazhdim, me qëllim shpejtimin e procesit të fiskalizimit, rritjen e saktësisë së veprimeve dhe uljen e rrezikut të regjistrimit të dyfishtë të faturave. Komisioni Prokurimit Publik vlerëson se ky kriter i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor e tejkalon atë për çka kërkohet të arrihet me këtë procedure prokurimi. Referuar ligjit të posaçëm Nr 87/2019 "PËR FATUREN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TE QARKULLIMIT". Neni 37 përcaktohen subjektet

të cilat ofrojnë shërbimin për rregjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike. Në rastin konkret operatorët ekonomik nuk mund të shfaqen në cilësinë e subjekteve të cilat ligji i mësipërm parashikon. Operatori ekonomik mund të ndërtojë një sistem por jo të marrë tagrin e një subjekti ku duhet të ketë çertifikimin si prodhues sistemi software nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose distributor i autorizuar nga prodhuesi si dhe për mirëmbajtjen e zgjidhjes softwar-ike për fiskalizimin, të veprimeve: *Për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike*”, pasi në ligjin Nr 87/2019 "PËR FATUREN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TE QARKULLIMIT”, përcaktohen saktë institucionet të cilat mund të kryejnë këtë rregjistrim siç janë Bankat, institucionet e tjera financiare jobankare apo subjekte të tjera.

Ndaj referuar arsytimit si më sipër kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe jo në proporcion me objektin dhe me shërbimet që do të kryhen. Akoma më tej bazuar në legjislacionin ku autoriteti mbështetet në përcaktimin e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues nuk ndodhet para kushteve të përcaktuara nga ligji i sipërcituar pasi nuk është institucion Bankar, institucion tjetër financiar jo bankar apo subjekt tjetër, në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të heqë këtë kriter pasi nuk i përket operatorëve ekonomikë sepse ato nuk gëzojnë statusin një institucion Bankar, apo institucion tjetër financiare jo bankar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK se: [...] *Specifikimet teknike Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.a ka parashikuar Piken 1 objektivat, Qellimin dhe rezultat e prituraë dhe me konkretisht ne piken 1 Qellimi ka vendosur si qellim te kesaj procedure dhe piken 3 aplikim Mobile (Mobile Apps), per aksesin ne sistemin e faturimit perfshire akasin ne faturat e shitjes dhe ato te blerjes. Gjithashtu ne tabelen e sherbimeve ne piken 1 te kesaj tablele AK ka parashikuar sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures per periudhen 1 vjecare. Versioni ëeb si dhe Mobile appsë. Referuar specifikimeve teknike theksjome qe kjo eshte nje kerkese e cila eshte totalisht ne bindjen tone e pakuptimte dhe eshte perdorur nje menyre per te kufizuar ne menyre te padrejte procedure. Rikujtojme qe KPP ne shume vendime te saj eshte shprehur kunder kufizimit te procedurave te prokurimit publik duke vendosur kriteret e dukshme ose te padukshme. Ne bindjen tone te plote aksesit i nje sistemi te fiskalizimit nepermjet **APP Mobile** eshte totalisht jo eficient pasi nuk mund te perdoret ne menyre efektive dhe mund te shkaktoje problematika ne fiskalizimin e faturave ne rastin UKT dhe te perdoreusve te saj. Rrjedhimisht ketu ngrejme pikepyetje te medha pasi ne vetvete kemi te bejme me nje institucion publik dhe sic ndodh ne menyre natyrale stafi i departamentit te finances i cili punon me sistemin e fiskalizimit pergjithesisht ne nje institucion publik, punon nga zyra, ku aksesimi i sistemit behet nepermjet pajisjeve kompjuterike me kapacitet te plote perpunimi dhe ekrane te pershtatshme per sisteme te cilet trajtojne dhe paraqesin volume te konsiderueshme te dhenave. Nga ky arsyetim del i pakuptimte aksesimi programit te fiskalizimit nga pajisje Mobile. Dukshem kemi te bejme me nje kriter te fshehur qe kerkon te diskriminoje operatoret ekonomike te interesuar dhe te kufizojte ne menyre te padrejte kete procedure prokurimi. Per sa cituam me lart kerkojme modifikimin e specifikimeve teknike duke e hequr kete kerkese.[...]*

III.2.1 Referuar-kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

Ne lidhje me nevojën e teknologjive mobile në operacionet që lidhen me faturimin apo ndjekjen dhe verifikimin në vazhdimësi të faturave, ju bejme me dije, se procesi i faturimit, sistemi i faturimit, ai i sistemit të fiskalizimit apo të tjera që lidhen me faturimin janë në qendër të operacioneve në UKT si dhe të marrëdhënieve midis kësaj të fundit dhe konsumatorëve individuale. Bazuar në rendesinë e faturimit si dhe të operacioneve që lidhen me to theksojmë që aplikimi i teknologjive të ndryshme, i kanaleve të ndryshme të leshimit, verifikimit të faturave apo të pranimit të pagesave cash apo mjete alternative pagese karte banke (apo para jo elektronike është domosdoshmeri) për çdo institucion utilitar gjendror me një numër të lartë abonentesh sikurse UKT. Krijimi i kanaleve të komunikimit të brendshëm apo me abonentet është një nga prioritetet e modernizimit të UKT. Për më shumë komunikimi kërkohet të gjithanshëm online, ëëb desktop apo mobile të cilës operatori ekonomik ankimes i referohet. Në nevojën e brendshme për modernizim aplikimi i teknologjive të fundit në treg (ku Teknologjia mobile në fakt nuk mundet të quhet më e re nevojë për operimin mobile del nga vetë kërkesa e ligjit për fiskalizimin e çdo veprimi në arke. Duke pasur parasysh numrin e lartë të veprimeve, shtrirjen e rrjetit (arkave) aktuale çdo teknologji komunikimi dhe operimi përfshirë ato mobile është e domosdoshme. Duke pasur parasysh numrin e veprimeve operimi manual apo me blloqe nuk është i mundur. Në rastet e problematikës së infrastrukurës, rrjetit, paisjeve lidhjes internet në zyrë apo tjetër të ngjashëm teknologjia mobile dhe e fiskalizimit online ka një rol të pazëvendësueshëm dhe garanton vazhdueshmerinë e operimit dhe shërbimit të abonentëve. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, për kufizimin e konkurrencës në procedurë në kushtet kur ka një mundësi në treg për këto zgjidhje, vërejmë se, kjo teknologji mobile nuk është një teknologji e re dhe për më shumë numri i operatorëve të certifikuar pranë tatimeve që e ofrojnë këtë shërbim (nga një verifikim online) është i shumtë. Për sa më sipër, mendojmë se pretendimi Juaj, në të cilin shpreheni se "dukshëm kemi të bejme me një kriter të fshehur që kërkon të diskriminojë operatorët ekonomik të interesuar dhe të kufizojë në mënyrë të padrejte këto procedurë prokurimi" nuk është i bazuar. Nderkohe, duke bërë vlerësimin e shërbimeve të kërkuara, në rিপërcaktimet e grafikut të levrimit, për zgjidhjen mobile, koha e levrimit do të jetë e mëvonshme dhe levrimi i këtij komponenti do të kryhet në muajin e dytë vetëm pas zbatimit të plotë të komponenteve të tjera të projektit. Për sa më sipër ju bejme me dije se pretendimi juaj qëndron dhe për rriedhojë pranohet pjesërisht.

III.2.2. Në shtojcën 5 “Shtojca 5 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimes përcaktohet si më poshtë:

1. **OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA**

1. **Qëllimi**

Qëllimi i krijimit të këtij Sistemi Informatik është

- *Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures për periudhën 1 vjeçare. Përfshirë 10 përdorues për hedhjen e faturave të shitjes si dhe për pranimin e atyre të blerjes.*
- *Moduli i lidhjes automatike me modelin API për raportimin e faturave të shitjes nga sistemi i brendshëm i faturimit e fatura.*
- ***Aplikim Mobile (Mobile Apps), për aksesin në sistemin e faturimit përfshirë aksesin në faturat e shitjes dhe ato të blerjes.***
- *Instalim & trajnim stafi*
- *Mirembajtje në vend për periudhë 1 vjeçare*

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” i Ligjit Nr.162/2021 “Për prokurimin publik” 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Neni 21 i Ligjit Nr.162/2021 “Për prokurimin publik” : Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.2.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve ” pika 2,5 dhe 7 Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “. **Neni 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve**

2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

7. *Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur.*

III.2.5 . Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në

përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve/shërbimi. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve

teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testim, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet*

publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specififikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specififikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafshuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit)*, interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson, se fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specififikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specififikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin, se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtarë/ndërkombëtarë me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet ti përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik.

III.2.7. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra

thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces. Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime apo kritere kufizues e përjashtues, në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të kenë një Aplikim Mobile (Mobile Apps), për aksesin në sistemin e faturimit përfshirë aksesin në faturat e shitjes dhe ato të blerjes, marrë në konsideratë dhe argumentimin në kthim përgjigjen e autoritetit lidhur me këtë pikë.

Akoma më tej bazuar në sa më sipër në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, se kërkesat e autoritetit kontraktor nuk janë të logjikshme, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kërkesat e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto specifikime në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të paqarta dhe konfuze. Akoma më tej theksojmë se lidhur me këtë pretendim autoriteti kontraktor e ka pasqyruar këtë kërkesë si element në “*Lista e çmimeve të shërbimeve*” ku citohet “*Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures per periudhen 1 vjecare. Versioni ëeb si dhe Mobile APPS*”, për të cilën nga ana juaj nuk është ngritur asnjë pretendim lidhur me këtë sesion. KPP thekson se fondi limit i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor është shumatorja e elementëve të shërbimeve të kërkuara në këtë procedurë, pasqyruar këto të fundit në shtojcën 2 “*Lista E Çmimeve Të Shërbimeve*” .

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK se: [...]Duke ju referuar kesaj kerkese ne opinionin tone mendojme qe kerkesa sipas se ciles per punonjesit qe disponojne certifikimet e kerkuar operatori ekonomik ofertues perpara publikimit te fituesit paraprak duhet te paraqese kontratat e punes eshte e ekzagjeruar dhe jo ne proporcion te drejte me kete procedure. Ne vetvete autoriteti kontraktor me kerkesen per listpagesen e muajit te fundit E-sig e ka ezauruar kete kerkese, pasi eshte ky formular qe tregon qe punonjesit jane ne nje marredhenie pune me operatorin ekonomik. Kerkesa per kontraten e punes nuk i jep asnje informacion te nevojshem per zbatimin e kontrates dhe rrjedhimisht eshte ne tje kalim te kerkeseve legjitime per kete procedure prokurimi. Kujtojmë qe autoriteti kontraktor me ane te kriterëve te vendosura kerkon qe te jete i sigurt qe operatori ekonomik ofertues disponon te gjithë kapacitetin profesional per zbatimin me rigorozitet te kontrates dhe sic e theksuam me lart kete kerkese e ka ezauruar me ane te kerkeseve per listpagesen e muajit te fundit te formularit E-sig. Per me teper ne procesverbalin e argumentimeve nuk gjejmë ne asnje rrjesht qe autoriteti kontraktor te kete argumentuar domosdoshmerine me patjeter te kesaj kerkese per tu plotesuar. Jemi te bindur qe heqja e kesaj kerkese nuk ndikon aspak ne realizimin e kontrates objekt prokurimi nga operatori ekonomik ne menyre rigoroze dhe me perpikmeri sipas kerkeseve ne DST. Per sa cituam me lart kerkojme modifikimin e ketij kriteri duke e hequr kete kerkese.[...]

III.3.1 Referuar-kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se: Shkalla e mirë-operimit te sistemit ka nje ndikim te drejtpërdrejte ne te gjitha proceset e brendshme te UKT. Numri i faturimeve (sikurse eshte përcaktuar ne ToR) eshte i larte. Proceset e brendshme te faturimit, raportimit pranë tatimeve, printimit si dhe shpërndarjes jane te mirepercaktuara dhe te ngjeshura ne kohe. Në perllogaritjen e kryer procesi i fiskalizimit kerkohet te mbyllet sa me shpejte, te jete i besueshem dhe duke perfshire problemet teknike te mundshme, procesi I ciklit te faturimit duhet te mbyllet në 3 dite dhe të mundesoje ne kushte optimale, nje shpejtësi fiskalizimi prej jo më pak se 100,000 Fatura në ditë. Personeli I kerkuar ne piken 2.5, është bazuar referuar VKM Nr.239, date 20.3.2020 PER KERKESAT TEKNIKE DHE FUNKSIONALE TE ZGIDHJES SOFTËAREIKE PËR PROCEDUREN E FATURIMIT DHE TË FISKALIZIMIT SI DHE PROCEDUREN E KRITERET PER REGISTRIMIN E PRODHUESVE E TË MIRËMBASTËSVE TE ZGJIDHJEVE SOFTEARE-IKE (ndryshuar me VM nr. 433, date 15.7.2021; nr. 725, date 13.12.2023), ne piken 7.a ku percaktohen kerkesat per te ushtruar veprimtari si prodhues dhe/ose mirëmbajtës i zgiidhjes softeware-ike percaktohen kerkesat në vijim: '...te punësuar nga aplikanti per te paktën 6 muaj para paraqitjes se aplikimit te regjstrimit ne register, me kualifikimet e duhura, dhe shogeria te permbushe kriteret e meposhtme:

- Te kete te paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per zhvillim dhe mirembajtje infrastrukture;
- Te kete te pakten I (nje) punonjes te certifikuar për zhvillim dhe mirembajtje neteork-u;
- Te kete te pakten 1 (një) punonjes te certifikuar për zhvillim dhe mirembajtje aplikacioni ëeb/mobile. Ndersa ne piken 8.d te te njejtes VKM përcaktohen: '

d) Dokumentet ge duhen paraqitur janë, si me poshtë vijon: i. Kopje e kontratës së punes me punonjesit e përmendur në piken 7, të ketij vendimi, dhe certifikatat perkatëse;' Persa me siper, vlerësojme se kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit jan° plotesisht te argumentura, nderkohe qe kerkesa per kontratën e punes është pikerisht ne perputhje me percaktimet e kësaj VKM-je (pika 8.d). Për më shume, gjejmë me vend te theksojme se sherbimi i kerkuar si dhe

ngarkesa është e tipit të vazhdueshëm. OE duhet të garantojë që në përputhje edhe me VKM-ne të këtyre personelin e certifikuar përgjate të gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nepërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerit, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.3.2. Në shtojcën 8 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) 1 punonjës të certifikuar për mirëmbajtje rrjetesh.
- b) 1 punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni ëeb.
- c) 1 punonjës të certifikuar për sisteme cloud.
- d) 1 punonjës të certifikuar për baza të dhënash.

Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë muajin e fundit.

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kontratën e punës

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c) Listëpagesën e muajit të fundit.

Shënim: Për piket 2.5 operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.3.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” i Ligjit Nr.162/2021 “Për prokurimin publik” 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 i Ligjit Nr.162/2021 “Për prokurimin publik” : Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.3.4 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve ” pika 2,5 dhe 7 Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “. **Neni 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve**

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që shërbimi objekt prokurimi për të cilët operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të ofertojnë, të jenë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe çmimit, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor lidhur me *disponimin e punonjësve* ku për përmbushjen e kësaj kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm :a.Kontratën e punës b.Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi. c) Listëpagesën e muajit të fundit.

Komisioni gjykon se bazuar në objektin, kërkesa mënyrën e përmbushjes së kriterit për disponimin punonjësve ku kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a.Kontratën e punës b.Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi. c) Listëpagesën e muajit të fundit” kjo kërkesë është e ekzagjeruar, pasi referuar qëllimit të përmbushjes së kësaj kërkesë, nga

ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar një element i posaçëm për verifikimin e disponimit të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomik.

Qëllimi i autoritetit kontraktor është të sigurohet që operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të kenë personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, por kjo kërkesë përsa i përket fuqisë punëtore, plotësohet nëpërmjet paraqitjes së Listëpagesës së muajit të fundit. Në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit duke rishikuar edhe njëherë kërkesat e kualifikimit përsa i përket disponimit të punonjësve duke hequr kriterin mbi paraqitjen e “*a.Kontratën e punës*”. Theksojmë se në çdo rast Autoriteti Kontraktor mund ti kërkojë sqarime operatorit ekonomik për çdo paqartësi apo verifikime mbi dokumentacionin në përputhje me neni 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar ku citohet “*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*”

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Kreatx” SHPK ne ankesën e paraqitur ku parashtron si më poshtë: [...]4.*Ne specifikimet teknike Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.a ka parashikuar piken 6 afati kohor i implementimit te projektitë ne te cilin ka specifikuar bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit, vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 1 muaj. NË vijim paraqitet procesi në formën e një diagrame Gant duke e ndarë projektin në nivel të proceseve kryesore që pritet të zhvillohen: Referuar kesaj pike ne specifikimet teknike dhe tabelës se shërbimeve sipas përshkrimit konstatohet nje mosrakordim ndërmjet afatit te implementimit te parashikuara ne piken 6 dhe afatit kohor te parashikuar ne tabelen shoqeruese ne po kete pike. Me konkretisht AK eshte shprehur se vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 1 muajë ndërsa po ti referohemi tabelës shoqeruese del e qarte qe nje pjese e implementimit do te zgjase dy muaj me konkretish pikat 2, cka rrjedhimisht e ben qe i gjithe implementimi te zgjasi dy muaj duke ju referuar tabelës. Sic mund te shihet qarte me menyren e hartimit te ketij kriteri krijohet konfuzion te operoret ekonomike dhe ne kete menyre do e kene te pamundur hartimin e ofertes ekonomike te sakte dhe reale. Per sa cituam me lart kerkojme modifikimin e specifikimeve teknike duke përcaktuar qarte sa do te jete afati i implementimit.[...]*

5...*Ne specifikimet teknike Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.a ka parashikuar piken 6 afati kohor i implementimit te projektitë ne te cilin ka specifikuar bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit, vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 1 muaj. NË vijim paraqitet procesi në formën e një diagrame Gant duke e ndarë projektin në nivel të proceseve kryesore që pritet të zhvillohen:*

Referuar pikes 6 ne specifikimet teknike dhe gjithashtu tabelës se shërbimeve dhe listës se cmimeve konstatojme qe ne specifikimet teknike eshte parashikuar dhe nje shërbim tjetër i cili nuk eshte pasqyruar ne asnje prej tabelave pjees perberese e DST. Me konkretisht ne piken 6 te specifikimeve thuhet vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 1 muajë, pra rrjedhimisht ketu na pasqyrohet dhe nje

sherbim tjetër që operatori ekonomik duhet të bëjë gjatë zbatimit të kontratës sic është trajnimi i cili sipas parashikimeve në specifikime duhet të zgjasë 1 muaj. **Qartazi del që ky sherbim i parashikuar në specifikime nuk figuron në asnjë prej tabelave që janë pjesë integrale e DST të hartuar dhe publikuar nga autoriteti kontraktor. Per rrjedhojë dicka e tillë drejt konfuzion të operatorëve ekonomikë që në këto mënyra do të kenë të pamundur hartimin e një oferte ekonomike të sakte dhe reale e kjo mund të sjellë që dhe zbatimi i kontratës të jetë problematik. Per sa cituam më lart kërkojmë modifikimin e specifikimeve teknike duke përcaktuar qartë zërat e sherbimeve që duhet të kryejë operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës për të cilët do të ofertojë në këto procedura prokurimi.**

6 ... Gjithashtu ak ka parashikuar pikën 5 garanci dhe mirëmbajtje ku thuhet periudha e mirëmbajtjes garancisë së sistemit do të jetë për 1 vit. Referuar sa cituam më lart nga ana jone janë konstatuar disa parregullsi në lidhje me procesin e mirëmbajtjes, afatin kohor që duhet të kryhet ky proces dhe gjithashtu faktin e hartimit të këtij zëri nga ana e ak në mënyra jo të qartë, cka shkakton konfuzion dhe paqartësi. Me konkretisht duke u mbështetur në pikat e specifikimeve teknike del e paqartë për afatin se kur duhet të fillojë kjo mirëmbajtje, nëse do të fillojë që në momentin e nënshkrimit të kontratës apo në momentin e marrjes në dorezim nga autoriteti kontraktor të sistemit me të gjithë zërat? Gjithashtu po të shikojmë zërat në tabelat që janë pjesë integrale të kësaj procedure zëri i mirëmbajtjes ka një formulim të cuditshëm, me konkretisht të ky zëri thuhet mirëmbajtje në vend për periudhë 1 vjeçare.

Në mënyra të cuditshme konstatohet një togfalesh të cuditshëm **mirëmbajtje në vendë dhe** e kemi të paqartë se çfarë ka dashur të thotë autoriteti kontraktor dhe perse është shprehur në këto mënyra kur sic e ka thënë në specifikimet teknike kërkon një sistem që të jetë në cloud dhe duket e cuditshme se si mund të mirëmbahet në vend një sistem në cloud. Nisur nga sa cituam më lart hartimi i zërit të ofertës për mirëmbajtjen konstatohet qartësisht që është bërë në mënyra jo të qartë dhe rrjedhimisht shkakton konfuzion të operatorëve ekonomikë të interesuar. Rrjedhimisht operatori ekonomik i interesuar e ka të pamundur hartimin e një oferte ekonomike të sakte dhe reale e kjo mund të sjellë që dhe zbatimi i kontratës të jetë problematik. Per sa cituam më lart kërkojmë modifikimin e specifikimeve teknike duke hartuar saktë zërin e ofertës për sa i përket mirëmbajtjes ku të përcaktohen qartë dhe afati kohor kur do të fillojë mirëmbajtja.[...]

III.4.1. Referuar-kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

4. Referuar-kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

Në interpretim të përcaktimeve në ToR, dhe për të sqaruar këtë përcaktim, theksojmë se, koha 4 javore i referohet vetëm pikës 'Moduli i lidhjes automatike me modelin API për raportimin e faturave të shitjes; nga sistemi i brendshëm i faturimit?'. Pas kësaj periudhe (dhe brenda 1 muaji) mendohet të këto filluar operimi i raportimit automatik në modelin API. Ky modul i cili ka të bëjë edhe me shkëmbimin automatik të informacionit midis sistemeve mendohet të shoqërohet me testim të tij. Trajnimi për këto ndërfaqe është minimal dhe lidhet me shumë me testimin e tij dhe ndjekjen e operimit por jo një trajnim që shtrihen në përdorues fundor të sistemit. Të gjitha pikat e tjera (vec aplikimit Mobile) duhet të levrohen sic janë përcaktuar, brenda muajit të parë përfaqësojnë trajnimin përkatës.

5.Referuar kerkeses per trajnim, lutem referuar ToR, ne to disa nga pikat ku percaktohen kerketat kryesore per trajnim jane si meposhte: Pika 1, ToR Qellimi, Qellimi i krijimit te ketij Sistemi Informatik eshte .. (pika fundit) Instalim & trajnim stafi; - Pika 2, Rezultatet qe Duhet te Arrihen nga Kontraktori (pika e fundit) 'Kontraktori duhet te beje trajnimin e stafit te perfshire sipas nje kalendari te dakordësuar midis palëve. Stafi qe do te trajnohet do të ndahet në grupe sipas roleve që do të kene ne sistem. - Pika 3, Detyrat specifike. (pika fundit 6) Trajnimet per te gjithë stafin që do të perdori këtë sistem (te ndara per përdoruesit e sistemit dhe administratoreve të sistemit) - Pika 6, Kerketat funksionale (pika e fundit) Trajnimi eshte i perfshire ne kete projekt dhe do te ofrohet nga Operatori Ekonomik fitues. Ky ze eshte I nevojshem per secilin nga komponentet e projektit dhe funksionalitet te ofruar nga OE. Për kete kerkohet qe 'Kontraktori duhet te bëje trajnimin e stafit te perfshire sipas nje kalendari të dakordësuar midis paleve. Stafi që do te trajnohet do të ndahet ne grupe sipas roleve që do të kene n° sistem'. Duke qene qe kerketat e UKT bazohen ne zbatimin e nje zgjidhje te certifikuar dhe pa modifikime materialet e trajnimit që do te aplikohen mendohet të jene ato standard te produktit. Per sa me sipër iu bejmë me dije se pretendimi juai gendron dhe për rriedhojë pranohet pjesërisht.

6. Referuar, periudhes se garancise theksojme se ajo eshte 1 vjecare dhe fillon vetëm pas pranimit dhe fillimit te operimit te komponentit perkates. Cdo komponent i cili nuk është pranuar nuk mundet te kaloj ne mirembajtje. Ndërsa në termat e mirembajtjes se sherbimit, lutem termat percaktohen me shume ne seksionin '5 Garancia & Mirembajtja' te Termave te References. Ketu percaktohen ndër të tjera koha e pergjigjes, termat e pergjigjes si dhe koha e zgjidhjes se problemeve. Lidhur me percaktimin 'Mirembajtje ne vend' kjo i referohet te gjithë komponenteve softëare te cilet jane te nevojshme per zbatimin ne paisjet lokale dhe qe ka te bej kryesisht me komponentin API te komunikimit midis sistemit te al-billing me sistemin e fiskalizimit ne cloud; por edhe me ndonje komponent tjeter qe OE e shohin te nevojshme[...]

III.4.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor datë 17.01.2024 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

ISHTE:

Bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit, vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 1 muaj. Në vijim paraqitet procesi në formën e një diagrame Gant duke e ndarë projektin në nivel të proceseve kryesore që pritet të zhvillohen:

Nr	Përshkrimi i mallrave	Muaji		
		I	II	III - XII
1	Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures per periudhen 1 vjecare. Versioni ëeb si dhe Mobile APPS.	X		
2	Moduli i lidhjes automatike me modelin API per raportimin e faturave te shitjes; nga sistemi i brendshem i faturimit.	X	X	

3	<i>Sistemi i leshimi i faturave manual ne zyrat rajonet e UKT;</i>	X		
4	<i>Sistemi i miratimit te faturave ne blerjen, ne nje ëorkfloë me minimalisht 3 hapa / aprovime</i>	X		
5	<i>Mirembajtje ne vend per periudhe 1 vjecare. Sistemi i raportimit BI, mbi raportimin dhe analizen mbi faturat, si dhe ËEB per raportimin online te faturave.</i>	X	X	X

Shenim: Sistemi qe kerkohet te prokurohet duhet te jete i gatshem dhe te kete marre paraprakisht lejet apo licensimin e nevojshem te AKSHI apo te Drejtorise se Pergjitheshme te tatimeve. Nderhyrje apo zhvillime ne program per nevoja te UKT nuk duhet te realizohen. Pershtatja me nevoje te UKT kerkohet vetem ne Integrimet me sisteme te UKT per fiskalizim si dhe per arkivim te faturave duhet te kryhen nepemjet nderfaqeve te hapura API te cila nuk kerkohet te jene specifike per UKT.

Per kete, koha e zbatimit 4 javore planifikohet te konsistoje ne testimet te API per UKT; ndersa dokumentacioni i pregatitur per perdoruesit eshte ai standard!

BEHET:

Bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit, vlerësohet që fillimi i operimit te secilit komponent te projektit do te jete si meposhte:

<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i mallrave</i>	<i>Muaji</i>		
		<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III - XII</i>
1	<i>Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures per periudhen 1 vjecare. Versioni ëeb si dhe Mobile APPS (*)</i>	X	X	
2	<i>Moduli i lidhjes automatike me modelin API per raportimin e faturave te shitjes; nga sistemi i brendshem i faturimit.</i>	X		
3	<i>Sistemi i leshimi i faturave manual ne zyrat rajonet e UKT;</i>	X		
4	<i>Sistemi i miratimit te faturave ne blerjen, ne nje ëorkfloë me minimalisht 3 hapa / aprovime</i>	X		
5	<i>Mirembajtje ne vend per periudhe 1 vjecare. Sistemi i raportimit BI, mbi raportimin</i>	X	X	X

	dhe analizen mbi faturat, si dhe ËEB per raportimin online te faturave.		
--	---	--	--

Shenim:

- 1) Sistemi qe kerkohet te prokurohet duhet te jete i gatshem dhe te kete marre paraprakisht lejet apo licensimin e nevojshem te AKSHI apo te Drejtorise se Pergjitheshme te tatimeve. Nderhyrje apo zhvillime ne program per nevoja te UKT nuk duhet te realizohen.
- 2) Pershtatja me nevojat e UKT kerkohet vetem ne komponentin e dyte (Moduli i lidhjes automatike me modelin API per raportimin e faturave te shitjes; nga sistemi i brendshem i faturimit) ku do te realizohet integrimi me sisteme te UKT (al-billing dhe email).
- 3) Koha e zbatimit 1 muaj planifikohet te konsistoje ne testimet te API per UKT; ndersa dokumentacioni i pregatitur per perdoruesit eshte ai standard! Trajnimi per kete komponent teknik (te komunikimit midis sistemeve) duhet te adresohet per personelin teknik IT te UKT! Ky material duhet te levrohet perpara realizimit te testimeve.
- 4) Trajnimi i perdoruesve, per secilin modul te sistemit duhet te kryhet ne menyre te vecante, dhe mbi grupet e perdoruesve per modulim perkates. Plani i trajnimit koordinohet me grupin e zbatimit te UKT; Trajnimet duhet te jene te vecanta per secilin modul.
- 5) Zbatimi i secilit modul (perfshire edhe trajnimin perkates) nuk duhet te zgjas me shume se nje muaj nga nenshkrimi i kontrates;
- 6) (*) Versioni Mobile APPS duhet te levrohet ne jo me shume se 2 muaj nga nenshkrimi i kontrates;
- 7) Garacia dhe mirembajtja fillon e vecante per cdo modul dhe menjehere pas pranimit perkates. Ajo ne perputhje me percaktimet ne DT eshte 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

III.4.3. Në shtojcën 2 “Lista e Cmimeve” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 2.
(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)
LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë. Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	Njësia	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.	Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures për periudhën 1 vjeçare. <i>Versioni ëeb si dhe Mobile APPS.</i>	1	vit		
2.	Moduli i lidhjes automatike me modelin API për raportimin e faturave të shitjes; nga sistemi i brendshëm i faturimit.	1	modul		
3.	Sistemi i leshimit të faturave manual në zyrat rajonale të UKT;	1	modul		
4.	Sistemi i miratimit të faturave në blerjen, në një ëorkfloë me minimalisht 3 hapa / aprovime	1	set		
5.	Mirembajtje në vend për periudhë 1 vjeçare. Sistemi i raportimit BI,	1	vit		

	mbi raportimin dhe analizen mbi faturat, si dhe ËEB per raportimin online te faturave				
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
	Çmimi Neto pa TVSH				
	TVSH (%)				
	Çmimi total me TVSH:				
	Emri i përfaqësuesit të ofertuesit				
	Nënshkrimi				
	Vula				
	Datë _____				

III.4.4. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.5. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.4.6. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.4.7. Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen*

në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.4.8. Në Nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. *Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

3. *Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

III.4.9. Në nenin 15 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se:

Neni 15

Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit

1. *Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.*
2. *Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:*
 - *njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit*
 - *njoftimin e kontratës;*
 - *ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);*
 - *udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;*
 - *kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;*

- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- deklaratën e informacionit konfidencial;
- formularin e ofertës ekonomike;
- sigurimin e ofertës;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- njoftimin e fituesit;
- formularin e ankesës;
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e lidhjes së kontratës;
- njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e lëvrimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

III.4.10. Referuar pretendimeve të ankimuesit “Kreatx” SHPK, KPP pasi mori në shqyrtim pretendimet e ankimuesit për sqarime në lidhje me dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, argumentet e dhëna nga autoriteti kontraktor në lidhje me specifikimet teknike të vendosura, si dhe nga shqyrtimi në tërësi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, vëren se specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk japin një përshkrim të plotë dhe detajuar të shërbimit të kërkuar dhe për rrjedhojë duhet të rishikohen nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim, në kushtet kur dokumentet e procedurës së prokurimit përmbajnë mangësi të rëndësishme të cilat vështirësojnë punën e ofertuesve për të përgatitur një ofertë të saktë në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret duhet modifikojë dokumentet standarte të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe të plotësojë çdo mangësi dhe të metë në hartimin e dokumenteve të reja të procedurës së prokurimit, në mënyrë që të shmangë çdo konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në modifikimet autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë pretendimet e ankimesit lidhur me pyetjet e ngritura në ankesë dhe çdo sqarim të dhënë ta bëjë pjesë të shtojcës 5 specifikimet teknike duke përshkruar në mënyrë të saktë dhe shteruese çdo element të shërbimit kohen që do të kryet cdo shërbim e cila do të realizohet nga ofertuesit.

Hartimi i specifikimeve teknike në mënyrë jo të plotë dhe të saktë shkakton paqartësi të cilat ndikojnë jo vetëm tek operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave të tyre, por edhe vështirësojnë punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të cilët do të detyrohen të vlerësojnë procedurën mbi kritere të paqarta, konfuze dhe që shkaktojnë pabarazi në vlerësimin e ofertuesve.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se kërkesat kualifikuese/specifikimet teknike të procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit apo specifikimit teknik si në rastin konkret, dhe mos unifikimi i tyre në shtojcat e DST, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

KPP gjykon, se specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk janë hartuar të sakta dhe nuk shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për shërbimin e kërkuar. Në këto kushte KPP gjykon, se paqartësitë e krijuara në këtë rast për shkak të të metave të rëndësishme në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përbëjnë shkak për mos hartimin saktë të ofertës së operatorëve ekonomik të interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duket të unifikojë kërkesat e tij në çdo shtojcë, dhe të modifikojë duke saktësuar çdo kërkesë dhe të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke përcaktuar qartë detyrat dhe rezultatet që duhet të arrijë kontraktori në realizimin e kësaj kontrate prokurimi, të pasqyrojë saktë zërat e shërbimit.

Referuar arsyetimit të mësipërm, pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-92509-12-29-2023, me objekt “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat” me fond limit 6,932,677.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-01-2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri

